



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 9, paragrafët 1 me nënparagrafin 1.1 , 1.6, 1.11 dhe nenit 21, paragrafi 2 dhe nenit 78 paragrafi 2 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OFK-së, nr. 275, datë 30.12.2024, në mbledhjen e mbajtur më 26.05.2026, miraton këtë:

VENDIM

I. Caktohen lokacionet e vendvotimeve në njësitë zgjedhore si më poshtë:

I.1. Njësia Zgjedhore – Regjioni Prishtinë - Vendvotimi caktohet në selinë e Odës së Farmacistëve të Kosovës.

I.2. Njësia Zgjedhore – Regjioni Mitrovicë - Vendvotimi caktohet në Spitalin e Përgjithshëm të Mitrovicës “Dr. Sami Haxhibeqiri” – pjesa e telemjekësisë.

I.3. Njësia Zgjedhore – Regjioni Pejë - Vendvotimi caktohet në Spitalin e Përgjithshëm të Pejës – salla e mbledhjeve të drejtorisë.

II. Në njësitë zgjedhore – Regjioni Prizren, Regjioni Ferizaj, Regjioni Gjilan, Njësia dhe Regjioni Gjakovë nuk do të organizohet procesi i votimit, pasi numri i kandidatëve për anëtarë Kuvendi është i barabartë me numrin e anëtarëve që zgjedhin këto njësi zgjedhore. Rrjedhimisht, të gjithë kandidatët në mungesë të kundërkandidatëve nga këto njësi konsiderohen të zgjedhur anëtarë të Kuvendit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në koordinim me Sekretariatit e KQZ-së, Komisionet e Njësive Zgjedhore (KNJZ) dhe institucionet përkatëse ku do të zhvillohet procesi zgjedhor, ka përcaktuar lokacionet për organizimin e vendvotimeve për zgjedhjet e anëtarëve të Kuvendit të Odës së Farmacistëve të Kosovës, duke marrë parasysh kushtet organizative, teknike dhe qasjen e anëtarëve në procesin zgjedhor.

Po ashtu, KQZ ka shqyrtuar situatën zgjedhore në Njësine Zgjedhore – Regjioni Prizren, Njësine Zgjedhore – Regjioni Ferizaj, Njësine Zgjedhore – Regjioni Gjilan dhe Njësine Zgjedhore –

Regjioni Gjakovë, ku numri i kandidatëve për anëtarë të Kuvendit është i barabartë me numrin e mandateve që zgjedhin këto njësi zgjedhore.

Në këto rrethana, duke qenë se nuk ekziston konkurrencë zgjedhore ndërmjet kandidatëve, organizimi i procesit të votimit do të ishte formal dhe pa efekt juridik në rezultat përfundimtar, pasi kandidatët e certifikuar nga këto njësi zgjedhore konsiderohen të zgjedhur në mungesë të kundërkandidatëve dhe me plotësimin e kushteve ligjore për certifikim si anëtarë të Kuvendit.

Për këto arsye, KQZ ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në Gjyqin e Nderit të OFK-së, deri më datë 28.05.2026, përmes adresës elektronike: kqz.ofk1@gmail.com.

I dërgohet:

- Sekretariatit të KQZ-së;
- Anëtarëve nga njësitë zgjedhore

Kryetari i KQZ-së

per
Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
OFK - KQZ

Mr. Ph. Betim Ramadani

